



# DIREZIONE INVESTIGATIVA ANTIMAFIA

## NJOFTIM PËR SHTYP

### VIZITË PUNE E STRUKTURËS SË POSAÇME (SPAK) DHE E ZYRTARËVE TË LARTË TË POLICISË SHQIPTARE (ASP) NË DIA

Prej datës 4 deri më datë 7 nëntor disa Prokurorë të Strukturës së Posaçme kundër korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) dhe Zyrtarë të Lartë të Policisë shqiptare (ASP) zhvilluan një vizitë pune në Itali me në fokus aspektet operative të hetimeve financiare. Veprimtaria u realizua nga Drejtoria Investigative Antimafia dhe organizua nga Përfaqësia e OSBE-së në Shqipëri me mbështetjen e Ekspertit për Sigurinë e atij të Guardia di Finanza-s pranë Ambasadës së Italisë në Tiranë si edhe të Shërbimit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar Policor.

Në organizimin e kësaj vizite ndihmuan, krahas Përfaqësies së OSBE-së, edhe Zyra e koordinatorit për veprimtaritë ekonomike dhe mjedisore dhe Departamenti për kërcënimet transnacionale pranë Sekretariatit të OSBE-së.

Objektivi kryesor i veprimtarisë trajnuese që mbështetja ndaj Autoritetit gjyqësor dhe policisë shqiptare në luftën ndaj pastrimit të parave të fituara në mënyrë të paligjshme, në fushën e masave të parandalimit të veprave penale kundër pasurisë me synim fuqizimin e luftës ndaj krimit të organizuar transnacional.

Delegacioni u mirëprit nga Kreu i Drejtorisë Investigative Antimafia, Gen C.A. GdF. Michele Carbone i cili, gjatë fjalës së tij përshëndetëse, vuri theksin tek rëndësia e këtyre veprimtarive që bëjnë të mundur njohjen ndërpersonale dhe rritjen e besimit të ndërsjellë, kusht i domosdoshëm për bashkëpunimin në një sektor kaq delikat si ai i luftës ndaj krimit të organizuar dhe identifikimit të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme.

Gjatë kësaj veprimtarie doli edhe një herë në pah efikasiteti i luftës ndaj krimit të organizuar në kuadër të bashkëpunimit midis dy Vendeve, anëtare të OSBE-së.

Vizita bën pjesë në veprimtaritë e zhvilluara nga Përfaqësia e OSBE-së në Shqipëri në kuadër të programit të mbështetjes së sistemit të *law enforcement* shqiptar dhe të projektit rajonal të OSBE-së për rritjen e aftësive në luftën ndaj krimeve financiare.

Romë, 7 nëntor 2024